



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 26 tetor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri dhe Pal Lekaj.

Munguan: Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës nga Ministria e Diasporës: Valon Murati, ministër; Behar Isma, u.d. drejtor; Avdyl Lipoveci, drejtor; Osman Shahini, sekretar i përgjithshëm; Kushtrim Sheremeti, shef kabineti; Shyhrete Kastrati, drejtore; Ragim Zejnullahu, drejtor; Besarta Morina, asistente ekzekutive.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Aida Dërguti, deputete; Shefki Kastrati, NDI; Albert Krasniqi, Eugen Cakolli, KDI; Gurjet Zeka, LVV; Taulant Salihu, KREK; Mirlinda Kelmendi, praktikante dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 4, 5 dhe 7 tetor 2016;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Valon Murati;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, me ndryshimin e radhitjes së tij, gjegjësisht pika e parë e rendit të ditës, të jetë raportimi i ministrit.

2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Valon Murati

Elmi Reçica, njoftoi se Komisioni, bazuar në planin dhe programin e tij, ka ftuar ministrin Valon Murati në raportim dhe e falënderoi atë për raportin e dërguar me shkrim.

Z. Reçica tha se ministri është ftuar në raportim, sepse anëtarët e Komisionit janë interesuar të shohin se çfarë po ndodh me Ministrinë e Diasporës, me diasporën si tërësi dhe se cilat janë planet konkrete për të ardhmen.

Theksoi se 1/3 e qytetarëve tanë jetojnë jashtë dhe se ky fakt është i një rëndësie të veçantë, sepse me ndihmën e tyre, mund të krijohen raporte të mira me vendet ku ata jetojnë dhe të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare.

Shprehu gatishmërinë për mbështetjen e ministrisë në punën që është duke e bërë dhe tha se diaspora jonë ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm.

Valon Murati, tha se ky bashkëbisedim shërben për të kuptuar jo vetëm çështjet e ministrisë, por edhe për të kuptuar problemet me të cilat ballafaqohet diaspora dhe çfarë zgjidhje duhet të ofrojmë ne si shtet dhe si shoqëri. Diaspora është resurs njerëzor, intelektual, kulturor, politik, ekonomik dhe financiar, e cila nuk është si ajo e para 20 vjetëve, prandaj qasja ndaj saj duhet të jetë serioze dhe e përpunuar.

Njoftoi se me ligj janë të obliguar të merren me fuqizimin e bashkëpunimit ekonomik, promovimin e investimeve të diasporës dhe krijimin e lehtësirave për investime të diasporës në Kosovë.

Ministria e Diasporës ka punuar në krijimin e rrjeteve të bizneseve të diasporës; janë krijuar 23 rrjete në të gjithë botën, të cilat luajnë një rol të komunikimit në mes nesh dhe bizneseve të diasporës dhe në mes nesh dhe bizneseve të huaja.

Sa i përket sundimit të ligjit, njoftoi se ka insistuar që të zbatohet Ligji për gjykatat dhe të themelohet Divizioni për Çështjet Kontestimore të Investitorëve të Huaj, në kuadër të Departamentit për Çështjet Ekonomike, gjë që edhe është funksionalizuar.

Ai tha se Ministria e Diasporës është anëtarësuar në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe është udhëheqëse e Grupit për tërheqjen e investimeve nga diaspora, ku janë të përfaqësuar edhe rrjetet e bizneseve. Në Këshill, tha se janë trajtuar disa probleme siç është tarifa e energjisë elektrike gjatë dimrit, çështja e maksigrafit, çështja e sundimit të ligjit, funksionimi i gjykatave, çështja e tarifës kufitare dhe është kërkuar nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, që të hartojnë udhëzues, se çfarë hapash duhet bërë që të zgjidhet problemi me Kartonin e Gjellbër.

Si problematikë tjetër, ministri përmendi edhe çështjen e aftësisë profesionale të punëtorëve, sepse investitorët kanë probleme me gjetjen e punëtorëve profesionalë.

Z. Murati e informoi Komisionin se, sa i përket fushës ekonomike kanë bashkëpunim me ministrinë tjera dhe me organizata joqeveritare, si me GIZ-in dhe Odën Ekonomike Kosovare-Gjermane, me të cilën kanë organizuar panairin e punës me pjesëmarrës nga bizneset e diasporës, dhe si rezultat i këtij panairi, janë punësuar rreth 1000 punëtorë.

Sfidë për Ministrinë e Diasporës, përmendi çështjen e remitencave, të cilat vitin e kaluar kanë qenë rreth 750 milionë euro dhe shprehu mendimin se një pjesë të tyre duhet bërë përpjekje që të kthehen në investime.

Pjesë tjetër e aktivitetit të ministrisë, tha se është çështja e ruajtës së identitetit, arsimit, aktivitetet kulturore dhe njoftoi se vitin e kaluar janë nënshkruar dy marrëveshje me Republikën e Shqipërisë për organizimin e mësimi shqip në diasporë dhe për zhvillimin e aktiviteteve kulturore jashtë. Në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, tha se janë duke i shqyrtuar mundësitë e futjes së modaliteteve të reja të mësimi, siç janë mësimi online dhe mësimi për mes aplikacioneve të telefonit.

Po ashtu, njoftoi se me Odën e Avokatëve të Kosovës kanë organizuar një konferencë me juristët nga diaspora, të cilët Oda e Avokatëve është duke i futur në listën e saj të avokatëve.

Po ashtu, njoftoi se në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, janë hapur 3000 vende për praktikantë dhe se janë duke punuar në organizimin e Samitit të Diasporës, i cili mbahet me 18 – 20 nëntor 2016, në Tiranë.

Regjistrimi i diasporës, z. Murati tha se do të vazhdojë edhe për 5 vitet e ardhshme dhe se në mes të vitit të ardhshëm do të dalin me një raport. Njoftoi se këtë projekt e kanë gjetur me rreth 30.000 të regjistruar dhe se deri në fund të vitit presin të regjistrohen rreth 400.000 bashkatdhetarë.

Njoftoi se në Qeveri është miratuar koncept-dokumenti për diasporën, dhe se në bashkëpunim me Këshillin Britanik, janë duke hartuar një ligj të ri për diasporën, ku do të trajtohet çështja e qendrave kulturore. Po ashtu, njoftoi se është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me të gjithë kryetarët e komunave, që gjatë verës, komunat të mobilizohen më shumë.

Sfidë tjetër, tha se është çështja buxhetore, sidomos në fushën e arsimit, sepse me këtë buxhet nuk mund të realizohen marrëveshjet e nënshkruara.

Kërkoj që tek pagesat jashtë vendit të zbatohen kriteret e prokurimit sipas Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për shkak të vërejtjeve në raportet e auditimit.

Jetike për diasporën tonë, tha se është përfaqësimi i saj në institucionet e Kosovës dhe se zgjidhja e vetme është që të kemi vende të rezervuara për diasporën në Kuvendin e Kosovës, duke shtuar se kjo do ta shpëtonte diasporën nga politizimi.

Blerta Deliu-Kodra, shtroi pyetje lidhur me vendet e rezervuara: Çfarë mendimi ka ministri lidhur me idenë e shpërbërjes së Ministrisë së Diasporës, që po përmendet nëpër media? Si e sheh ai kampanjën e disa partive politike, që po kërkojnë mjete financiare në diasporë dhe si po destinohen këto mjete? Çfarë ka bërë ministria për eliminimin e sfidave për implementimin e marrëveshjeve për mësimin plotësues shqip në diasporë? Çfarë kanë arritur tri qendrat kulturore deri më tani, cili është funksioni i tyre primar dhe se çfarë po synohet të arrihet përmes tyre, kur dihet se në të njëjtat vende ka edhe misione diplomatike? Si është bashkëpunimi i ndërmjet qendrave kulturore dhe MPJ-së dhe a ka ndërhyrje të politikave?

Më tej, znj. Blerta Deliu-Kodra, pyeti se cilat janë arsytet e rënies së remitencave, se si duhet t'i bindim bashkëkombësit tanë që të vazhdojnë të investojnë në Kosovë dhe si do të diskutohet me diasporën, miratimi i Ligjit për investimet strategjike, që është miratuar në Kuvend, i cili premtonte klimë të mirë për investitorët; se çfarë ka bërë ministria lidhur me Fondin e Investimeve në Kosovë, si dhe lidhur me zbatimin e marrëveshjes për mësimin shqip në diasporë dhe për regjistrimin e diasporës.

Sa i përket rrjetëzimit të bizneseve të diasporës, shprehu mendimin se është një mundësi e mirë që bizneset shqiptare në diasporë të koordinohen dhe të përfitojnë nga krijimi i politikave të përbashkëta, me theks të veçantë, ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Pal Lekaj, tha se ka takuar shumë pjesëtarë të diasporës dhe theksoi se bindja e tyre është që shteti i Kosovës, i ka harruar ata dhe kjo është shqetësuese.

Sa i përket analizës për investimet e mundshme në Kosovë, tha se bizneset dhe individët janë pak të informuar që të investojnë në Kosovë dhe është krijuar një perceptim nga diaspora se në Kosovë ka vetëm parregullsi. Lidhur me këtë, pyeti se çfarë mund të bëjnë bashkërisht që të prezantohet Kosova, në mënyrë tërheqëse për të investuar.

Z. Lekaj, ngriti çështjen e policave të sigurimit; trajtimin e emigrantëve në shtetet tjera dhe kërkoj të informohet për kushtet e tyre.

Sa i përket problemeve buxhetore të ministrisë, shprehu mendimin se duhet të ndryshohet ligji dhe çështja e pagesave për Ministrinë e Diasporës, të rregullohet.

Ismet Beqiri, tha se puna e ministrisë kërkon përkushtim dhe angazhim, sepse diaspora është realitet, është nevojë, por edhe sfidë.

Shprehu mendimin se ministria duhet të ketë buxhet më të lartë dhe se gradualisht do të vijë koha kur Kosova nuk mund të investojë vetëm në infrastrukturë, por edhe në çështje tjera, siç është diaspora. Sa i përket vendeve të rezervuara, tha se është çështje e vullnetit politik dhe çështje kushtetuese. Mënyra më e mirë për ruajtjen e identitetit, tha se është jeta kulturore dhe arsimore, dhe diaspora, në rrethana të caktuara, ka vepruar ndryshe, duke protestuar me organizime politike e financiare, kurse tash është një realitet tjetër dhe duhet qasje tjetër ndaj saj. Po ashtu, z. Beqiri në fund shtoi se ministria do ta ketë përkrahjen e Komisionit, sepse kjo është një punë institucionale dhe nuk është punë vetëm e një ministrie, por e shtetit të Kosovës.

Aida Dërguti, tha se Ministria e Diasporës është një ndër të paktat që dorëzojnë raport me shkrim. Po ashtu, znj. Dërguti shtoi se një ndër arsyet kryesore për mungesë të investimeve nga diaspora, është se në shumicën e raporteve dhe hulumtimeve, theksohet korrupsioni i lartë në vend dhe brenda institucioneve administrative, duke krijuar kështu një mjedis të pafavorshëm. Pyeti: Ku janë krijuar ato 1000 vende të punës? Kur do të përfundojë regjistrimi i diasporës? Çfarë roli ka ministria në raport me Kartonin e Gjellbër? Lidhur me përfaqësimin e diasporës në Kuvend, pyeti se si do të reflektojnë kjo tek serbët, a do të futeshin në kotën e vendeve të rezervuara dhe a është ndërmarrë diçka në drejtim të lehtësimit të procedurave për votim jashtë vendit? Sa i përket qendrave kulturore, tha se informatat për aktivitetet e tyre janë të pakta dhe kërkoi të informohet se sa qendra tjera janë në plan të hapen dhe në bazë të cilave kritere do të hapen ato. Po ashtu, më tej pyeti: Sa hulumtime dhe analiza janë bërë nga Divizioni i Hulumtimeve dhe Analizave të Diasporës dhe ku janë publikuar ato? Çfarë ka bërë deri më tani Divizioni i Koordinimit dhe Përkrahjes së Investimeve të Diasporës? A ka ndonjë strategji afatmesme apo afatgjatë për motivimin e investitorëve të diasporës, që është hartuar nga Divizioni i Koordinimit dhe Përkrahjes së Investimeve të Diasporës.

Luljeta Veselaj-Gutaj, duke iu referuar fjalës së ministrit, lidhur me hapjen e shkollave shqipe në diasporë, pyeti: Cilat janë shtetet me prioritet për hapjen e shkollave shqipe dhe se a është Zvicra në mesin e atyre shteteve? Sa i përket plakjes së mësimdhënësve në diasporë, pyeti ministrin: A është menduar në organizimin e mësimin në distancë, për ata që dëshirojnë të mësojnë me kurrikulat e Universitetit të Prishtinës apo ndonjë universiteti tjetër në Kosovë dhe se a mund të jetë kjo një formë e mësimin të gjuhës shqipe? Për shkollat shqipe, pyeti se si funksionojnë ato dhe se a e kanë kurrikulumin e njëjtë me shkollat në Kosovë apo kanë diçka më të veçantë.

Valon Murati, sa i përket vendeve të rezervuara, tha se është vullnet politik, se është i njohur me pengesat dhe se kjo çështje nuk mund të ndodhë në planin afatshkurtër. Përfaqësimi i diasporës në Kuvend do ta kishte zgjidhur problemin e votës, të përfaqësimit dhe të organizimit të partive politike, shtoi z. Murati. Lidhur me pyetjen e znj. Deliu-Kodra për idenë e shpërbërjes së ministrisë, tha se kjo nuk është në vullnetin e tij politik dhe se nuk ka asnjë njoftim zyrtar sa i përket kësaj çështjeje. Njoftoi se vitin e kaluar kanë dërguar rreth 35.000 mjete mësimore në diasporë, po ashtu njoftoi se aty ku organizohet mësimi në shqip, dërgojnë mjete mësimore, duke përfshirë edhe abetaren. Qendra kulturore duhet ta ketë rolin e komunikimit me kulturat ku ato janë të vendosura, tha z. Murati, dhe shtoi se ka probleme ligjore me funksionimin e tyre. Qeveria e Kosovës ka nxjerrë vendim për hapjen e qendrave kulturore në Gjermani, Francë, Austri dhe SHBA. Lidhur me këtë çështje, tha se për shkak të mjeteve buxhetore, këto qendra nuk mund të hapen. Pas hartimit të ligjit, njoftoi se do të hapet Qendra kulturore në Gjermani dhe ideja është që t'i bëjmë të vetë-mbajtshme. Sa i përket remitencave, tha se nuk ka tendencë të rënies, por si sfidë ceku kthimin e një pjesë të tyre në investime, sepse ato nuk futen në mënyrën e duhur, në ekonominë e vendit.

Në shumicën e vendeve, mësimi shqip tha se organizohet në shkolla edhe në ato vende ku shteti nuk e financon mësimin, ata së paku e ofrojnë objektin e shkollës për mbajtjen e mësimin të gjuhës shqipe. Si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Diasporës me ministrinë dhe organet tjera, tha se është arritur që tarifa e Kartonit të Gjellbër të ulet për 50%. Kosova, zyrtarisht, tha se nuk mund të bëhet anëtare e Kartonit të Gjellbër, por konsideron se ka hapësira dhe mund të lidhen marrëveshje me shtetet përkatëse.

Një prej problemeve kryesore për investimet, tha se është funksionimi i gjykatave dhe uzurpimi i pronave. Njoftoi se është krijuar Grupi për tërheqjen e investorëve nga diaspora, ku bëjnë pjesë përfaqësues nga Ministria për Zhvillimin Ekonomik, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave, Dogana, ATK-ja dhe nga rrejtja e bizneseve të diasporës, dhe se me këtë punë synohet të krijohet një klimë e mirë për investime dhe të largohet perceptimi i korrupsionit. Si pengesë tjetër për investime, z. Murati ceku edhe mungesën e pronave të Qeverisë dhe të komunave.

Sa i përket pyetjeve të deputetes Dërguti, tha se prej 1000 të punësuarve, 800 janë të punësuar në Kosovë, ndërsa në mungesë të kapaciteteve administrative të ministrisë, është kërkuar që të bëhen hulumtime në bashkëpunim me institucione të specializuara.

Sa i përket mësimin në distancë, tha se është pjesë e marrëveshjes së arsimit, e cila duhet të trajtohet edhe nga ana financiare.

Avdyli Lipoveci, njoftoi se kurrikulat e diasporës janë të veçanta. Mësimi në diasporë realizohet me dy kurrikula, me atë të Kosovës dhe të Shqipërisë dhe janë në fazë të unifikimit të kurrikulave. Mësimi në diasporë, tha se përqendrohet më shumë në gjuhën, kulturën, historinë dhe gjeografinë shqiptare.

Valon Murati, theksoi se sa i përket mospublikimit të hulumtimeve, e ueb-faqja e ministrisë është në përpunim dhe shumë prej hulumtimeve nuk janë rivendosur.

Shtoi se është mirë që në një moment të caktuar të mbahet një debat parlamentar për diasporën, ku do të trajtoheshin të gjitha këto çështje.

Elmi Reçica, tha se duhet të jemi më shumë në kontakt me njerëzit tanë në diasporë, sepse një pjesë e tyre janë të integruar në institucionet e shteteve përkatëse dhe mund të jenë urë lidhëse dhe mbështetës shumë të fuqishëm të të gjitha proceseve.

Lidhur me organizimin e diasporës, tha se ne duhet të organizohemi në bashkësi shqiptare, në kuadër të integriteteve evropiane, sepse jemi të shpërndarë, gjë që mund të planifikohet, sepse i takon së ardhmes.

Më tej, z. Reçica shtoi se është vendimtare që njerëzit tanë, që janë të suksesshëm në diasporë, duhet t'i mbështesim dhe kjo mund të na nxjerr nga gjendja ekonomiko-sociale, në të cilën jemi.

Po ashtu, z. Reçica tha se Komisioni është i interesuar që ministria të fuqizohet dhe të jetë bartëse e aktiviteteve të diasporës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica